

KOMUNA E DRENASIT



STRATEGJIA
e
ZHVILLIMIT
EKONOMIK LOKAL
2005 - 2007

Janar 2005

**PROJEKTI: Zhvillimi i Ndërmarrjeve Lokale nëpërmjet
Aksionit dhe Aleançës (DELTA II)**

**Projekt për zhvillimin ekonomik, i bashkëfinancuar nga
Instituti për Shoqëri të Hapur, komunat pjesëmarrëse dhe
“Friedrich Ebert Stiftung”**



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Vërejtje

Kjo strategji është hartuar nga Ekipi Komunal, me këshilla dhe udhëzime të Grupit të Bankës Botërore, Institutit për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-it. Grupi i Bankës Botërore, Instituti për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-i nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e kësaj strategjie, sidoqoftë ato përgëzojnë Ekipin Komunal për cilësinë e punës.

PËRMBAJTJA

	Faqe
HYRJE	1
I. ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE	2
II. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUES	7
III. ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)	15
IV. VIZIONI	17
V. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT	19
VI. AMZA: “NGA VIZIONI DREJT PROJEKTET”	21
VII. AMZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNIMET	25
VIII. PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKTEVE TË ZHEL-it	29
PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE	33
ANEKS 1: Grupet punuese	79
ANEKS 2: Kompanit më të mëdha në komunën e Drenasit	80

HYRJE

“Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e komunës së Drenasit 2005-2007” ka rezultuar nga Projekti DELTA II. Komuna e Drenasit është zgjedhur në këtë projekt së bashku me katër komuna të tjera të Kosovës¹.

DELTA II është bashkëfinancuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest, përderisa vetë komunat pjesëmarrje në projekt dhe “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) kanë kontribuar financiarisht në një masë më të vogël. Banka Botërore nga Uashingtoni mbështeti projektin duke i ofruar asistencë teknike. Projekti është implementuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest”, në Prishtinë. Synimi i projektit ishte “aftësimi i komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim të NVM (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme)”. Përveç synimit, DELTA II ka patur edhe disa objektiva, si forcimi i kapaciteteve të administratës komunale për të hartuar dhe implementuar Strategjitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL), mbështetja e komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e NVM-ve dhe forcimi i partneritetit ndërmjet qeverisë komunale, komunitetit biznesor dhe shoqërisë civile.

Strategjia përmban Vizionin, Synimet, Objektivat, Programet dhe Projektet, të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara me njëra-tjetrën. Strategjia do të konsiderohet si dokument zhvillimor bazë për Qeverinë Komunale të Drenasit për periudhën e ardhshme trivjeçare 2005-2007.

Si është hartuar Strategjia? Në fillim të procesit për hartimin e strategjisë janë formuar Ekipi Komunal për ZHEL dhe Grupi Punues, si dhe është themeluar Forumi i Palëve të Interesuara. Ekipi për ZHEL dhe Grupi Punues kanë marrë mbështetje politike nga udhëheqësit komunalë. Gjatë tërë ciklit hartues strategjik janë organizuar katër punëtori (workshope), në të cilat Ekipi për ZHEL i

¹ Pesë komunat pjesëmarrëse në projektin DELTA II janë: Gjilani, Peja, Ferizaj, Drenasi (ish-Gllogoci) dhe Lipjani.

komunës së Drenasit ka marrë pjesë aktive. Punëtoritë janë ndarë në orë teorike dhe praktike dhe i tërë procesi është moderuar/ndihmuar nga Ekipi Menaxhues i projektit DELTA II nga “Riinvest”-i, por gjithashtu edhe nga ekspertët vendorë nga “Riinvest”-i dhe konsulentët ndërkombëtarë. Pas çdo punëtorie janë përgatitur planveprimet, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes për Ekipin Komunal të ZHEL-it, për të zhvilluar aktivitetet hartuese strategjike. Ekipi Komunal, në bashkëpunim me Grupin Punues dhe i mbështetur nga palët e interesuara komunale, ka punuar në mënyrë fazore në disa aspekte, si grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave dhe definimi i Vizionit, Synimeve, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.

Gjithashtu, Ekipi Komunal për ZHEL mori pjesë në vizitën studiuëse në Slloveni, nga 26 shtatori deri më 2 tetor 2004, ku anëtarët e ekipit u informuan lidhur me përvojat sllovene në fushën e ZHEL-it, administratën lokale, hartimin e strategjive zhvillimore, zonat biznesore, inkubatorët biznesorë në Slloveni, etj.

I. ORGANIZIMI I PËRPJEKJEVE

Fillimisht komuna e Drenasit ka formuar ekipin e ZHEL-it, i cili përbëhej prej katër anëtarëve - tre prej tyre nga stafi i administratës komunale, kurse një nga komuniteti i biznesit. Pas kësaj janë formuar trupat punuese, si Grupet Punuese Komunale² dhe Forumi i Palëve të Interesuara. Këto grupe punuese e kanë ndihmuar ekipin komunal gjatë tërë fazave të projektit me të dhëna dhe këshillime, si dhe në shqyrtimin/rishqyrtimin e drafteve të strategjisë. Përfaqësuesit e Grupeve Punuese janë takuar më shpesh se Palët e Interesuara, dhe atë sipas kërkesave që kanë shtruar nevojat e projektit. Palët e Interesuara janë takuar katër herë, zakonisht në fund të çdo planveprimi. I tërë procesi i zhvillimit të projektit është koordinuar nga Ekipi Komunal për ZHEL, i cili ka qenë në kontakt të ditëpërditshëm me rrjedhat e projektit.

Ekipi komunal i ZHEL-it i komunës së Drenasit ka këtë përbërje:

- 1. Rustem Qorri** - drejtor i Drejtoratit për Ekonomi
- 2. Hamdi Qorri** - drejtor i Drejtoratit për Urbanizëm
- 3. Shehrije Mustafa** - Zyra e Biznesit
- 4. Mehdi Bresilla** - Komuniteti i Biznesit

Procesi i zhvillimit/aprovimit të strategjisë së ZHEL 2005-2007

Pas formimit të grupeve punuese, projekti ka vazhduar me mbledhjen e të dhënave dhe me analizën konkurruese të komunës (SWOT). Ekipi komunal ka bashkëpunuar me akterët e interesit të komunës në definimin e vizionit, qëllimeve dhe objektivave gjatë një periudhe tremujore.

Brenda aktiviteteve të projektit, me qëllim të shfrytëzimit të përparësive të komunës dhe të eliminimit të dobësive, me një fjalë, eliminimit të rreziqeve, ekipi komunal ka identifikuar të gjitha programet dhe projektet të cilat kanë shërbyer si bazë për qeverinë komunale në arritjen e qëllimeve të strategjisë.

Strategjia e ZHEL-it për komunën e Drenasit është prezentuar më 28.12.2004 para Bordit të Drejtorëve, para Komitetit për Politikë dhe Financa është

² Shiko përbërjen e këtyre grupeve në Aneks 1

prezentuar më 12.01.2005, ndërsa në Kuvend më 19.01.2005, ku është bërë edhe aprovimi i saj.

Struktura e Qeverisë Lokale

Asambleja e Komunës së Drenasit ka 31 këshilltarë, Komitetin për Politikë dhe Financa, Zyrën e Informimit dhe Zyrën e Revizorit. Qeveria komunale funksionon me Bordin e Drejtorëve me 10 drejtori, Zyrën e Avokatit Publik, Zyrën e Prokurimit dhe Zyrën për Barazi Gjinore.


Në Kuvendin Komunal punojnë 145 punëtorë, të cilët kanë për synim të sigurojnë mirëqenie të përgjithshme për qytetarët, krijimin e një rendi demokratik e ligjor mbi të cilin garantohen dhe realizohen të drejtat dhe liritë e njeriut, duke krijuar ambient të qetë për një zhvillim më të mirë të ekonomisë lokale, për të arritur përmirësimin e standardit jetësor.

Komuna e Drenasit qeveriset sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, e cila definon përgjegjësitë e qeverive komunale në Kosovë.

Përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë, sipas Rregullores së UNMIK, 2000/45 janë:

- § Sigurimi i kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- § Planifikimi urban dhe rural dhe shfrytëzimi i tokës;
- § Liçençimi i ndërtimeve dhe zhvillimeve të tjera;
- § Mbrojtja lokale e ambientit;
- § Implementimi i rregulloreve për ndërtim dhe standardeve për kontroll të ndërtimit;
- § Sigurimi i shërbimeve lokale publike dhe infrastrukturës, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë, kanalizimet dhe drenazhet, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave për nxemje lokale;
- § Shërbimet publike, duke përfshirë edhe zjarrfikjen dhe shërbimet emergjente;
- § Menaxhimi i pronës komunale;
- § Arsimit parafillor, fillor dhe i mesëm;
- § Përkujdesja primare shëndetësore;
- § Shërbimet sociale dhe të banimit;
- § Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndeti publik;
- § Licencimi i shërbimeve, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, transportin lokal publik dhe taksitë, gjuetinë dhe peshkatarinë, si dhe restorantet dhe hotelet;
- § Panairët dhe tregjet;
- § Emërimi dhe riemërimi i rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike;

- § Sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike dhe hapësirave të hapura dhe varrezave;
- § Aktivitetet tjera që janë të domosdoshme për administrim adekuat të komunës dhe të cilat nuk janë përcaktuar me ligj.



Buxheti komunal

Buxheti komunal sigurohet prej dy burime: donacionet nga qeveria qendrore dhe të hyrat vetanake komunale.

Tabela 1. Buxheti i planifikuar komunal për periudhën 2004-2007

Viti	Grantet				Të hyrat vetanake	Gjithsej
	Përgjithshme	Sektori i Arsimit	Sektori i Shëndetësisë	Zjarrfikësit		
2004	1,323,984	2,126,552	390,157	66,352	422,238	4,329,283
2005	1,623,660	2,126,552	390,157	66,352	475,675	4,682,396
2006	1,570,947	2,126,552	390,157	66,352	571,683	4,725,691
2007	1,570,947	2,126,552	390,157	66,352	628,851	4,782,859
Total	6,089,538	8,506,208	1,560,628	265,408	2,098,447	

Burimi: Drejtorati për Ekonomi, Drenas, 2003.

Nga tabela 1 shihet se pjesëmarrja e të hyrave vetanake në buxhetin total të Drenasit është shumë e vogël (më pak se 10%). Gjithashtu, shprehur edhe në vlerën absolute, vlera e të hyrave vetanake është e vogël. Pjesëmarrja e tatimit në pronë në të hyrat vetanake të komunës, që janë burimi kryesor i investimeve në infrastrukturën e rëndë në komunë e Drenasit, është shumë e ulët (më pak se 20%) në krahasim me nevojat.

II. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Historiku i shkurtër i komunës

Komuna e Drenasit ka një territor me sipërfaqe prej 270 km² dhe bën pjesë në grupin e komunave të vogla të Kosovës. Për një kohë të gjatë komuna e Drenasit ka qenë e orientuar në kultivimin e kulturave ekstensive bujqësore. Nismat e para të zhvillimit ekonomik kanë filluar në vitet e 70-ta, posaçërisht në vitet e 80-ta, me aktivizimin e “Feronikelit” në vitin 1984. Aktivizimi i Feronikelit pati një ndikim të madh në rritjen e zhvillimit ekonomik, me synime që brenda një kohë të arrihej te mesatarja e Kosovës pas prapambetjes shumëvjeçare. Punësimi i 2,200 punëtorëve, rregullimi i një pjese të infrastrukturës dhe ndërtimi i banesave ndikuan në krijimin e një standardi më të mirë për qytetarët e komunës.

Pozita gjeografike e Drenasit

Komuna e Drenasit ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i komunës së Drenasit gjendet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit, kështu që edhe paraqet një lidhje ndërmjet këtyre dy rajoneve. Kjo pozitë i mundëson që të jetë më afër qendrave të mëdha industriale dhe tregtare (Prishtina, Peja, Mitrovica).

Nëpër komunën e Drenasit kalon linja hekurudhore Prishtinë-Pejë, e cila nëpërmjet Fushë-Kosovës lidhet me Mitrovicën dhe me Shkupin. Pastaj rruga magjistrale Prishtinë-Pejë kalon nëpër Komoran, ku lidhet me Skënderajin, Mitrovicën etj. Të gjitha këto mundësojnë një lidhshmëri të mirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit me tregjet. Pra, kjo pozitë e komunës është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Pozita e Drenasit në Kosovë



Popullsia

Mbështetur në disa të dhëna³ (bazuar në rritjen vjetore të popullsisë prej 2.9%), numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën e Drenasit në vitin 2003 është 73.847, dendësia e popullsisë është 273/ km,² ndërsa mesatarja e anëtarëve për një familje është 9.

Struktura e popullsisë sipas moshës:

- 0 - 15 (35.3 %)
- 16 - 65 (59.9 %)
- Mbi 66 (4.8 %)

Punësimi

Shkalla e papunësisë në komunën e Drenasit është e lartë. Në bazë të disa të dhënave jozyrtare, numri i të papunëve të regjistruar është më i madh se i të

³ Të dhënat e fundit për regjistrimin e popullsisë janë bërë në vitin 1981, për shkak të problemeve politike (okupimi i Kosovës nga Serbia).

punësuarve, 9,160 në krahasim me 6,340. Megjithatë, numri real i të papunësuarve konsiderohet të jetë edhe më i lartë, duke marrë parasysh faktin se një numër i madh i qytetarëve nuk janë regjistruar si të papunë, sepse nuk shpresojnë se Zyra për Punësim do të jetë në gjendje të sigurojë ndonjë vend pune për ta.

Derisa kanë qenë në funksion kapacitetet prodhuese, numri i të punësuarve ka qenë shumë më i madh, sidomos në Feronikel, ku kanë punuar më tepër se 2.000 punëtorë, ndërsa tani punojnë vetëm 230 punëtorë, në Fabrikën e Tekstilit kanë punuar 280, ndërsa tani nuk ka të punësuar fare, në guroren “Ramiz Sadiku” kanë punuar 180, ndërsa tani punojnë vetëm 80.

Në mungesë të punësimit në këto kapacitete, një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private. Gjithsej janë të regjistruara mbi 1,500 biznese dhe këtu janë të punësuar pjesa më e madhe e tyre.

Infrastruktura

Infrastruktura në këtë komunë nuk është e kënaqshme. Rrjetet e rrugëve, ujësjellësve dhe kanalizimeve, si dhe përcusit elektrik dhe ata telefonik janë mjaft të dëmtuara.

Rrugët - Në territorin e komunës së Drenasit shumica e rrugëve janë në gjendje të vështirë dhe si problem kryesor është gjetja e mundësisë për asfaltimin e tyre. Për shkak të gjendjes jo të mirë të tyre, 15 km rrugë janë çdoherë të rrezikuara nga vërshimet si dhe 100 km rrugë shpeshherë bllokohen nga bora gjatë stinës së dimrit.

Ujësjellësit - Në krahasim me disa lëmi të tjera në përgjithësi në territorin e komunës së Drenasit, mund të konstatojmë se në rrjetin e ujësjellësit gjendja është më e mirë. Nga 63 km gypa të ujit, 30 km i kemi në gjendje të mirë, 20 km në gjendje mesatare dhe 13 km në gjendje më të dobët. Me menaxhimin dhe intervenimet e kohëpaskohshme merret NPSH “Komunalia”, që deri tani është kujdesur për mirëmbajtjen e stacionit të pompimit të ujit, riparimin e tërësishëm të pompave, rritjen e kapacitetit të ujit dhe rritjen e kapacitetit të grumbullimit të ujit.

Higjiena publike - Është në ngritje e sipër, me angazhimet e NPSH “Komunalia”, si dhe me ngritjen e vetëdijes së qytetarëve, mirëpo për të plotësuar nevojat e qytetarëve sistemi i kanalizimeve duhet të zgjerohet. Momentalisht janë të përdorshme 15 km të rrjetit të kanalizimit dhe prej tyre 11.5 km të kanalizimit fekal janë në gjendje mesatare, ndërsa 4.5 km janë në gjendje të dobët dhe kanë nevojë për t’u renovuar. Ekziston edhe sistemi i

gypave për grumbullimin e ujërave atmosferike, por ky rrjet duhet të vihet në funksion, me pak investime.

Mbeturinat - NPSH "Komunalia" është e pajisur me mekanizëm mjaft cilësor për bartjen e mbeturinave dhe e ka të përfshirë një pjesë të territorit të komunës, me synim që të vazhdojë edhe në pjesët tjera. Ekziston një deponi për huthjen e mbeturinave, por problemi qëndron në atë se nuk bëhet riciklimi.

Ndriçimi - Në komunën e Drenasit gjendja momentale e objekteve elektroenergjetike është shumë e dobët, pasi edhe lufta ka lënë pasoja me shkatërrimin e rrjetit të tensionit të ulët dhe të lartë. Pas luftës janë përmirësuar 25 km të rrjetit të tensionit të lartë, 50 km të rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV, si dhe janë zëvendësuar 27 transformatorë.

Telekomunikacioni – Ekzistojnë dy objekte të postave në Drenas dhe në Bushat. Kapaciteti momental i postës në Drenas në telefoninë fikse është 8500 numra, tani numri i telefonave celularë të Valës 900 në të dy postat është 7500 numra. Për informim të opinionit në tërësi ekzistojnë edhe dy radio lokale me program 24-orësh.

Edukimi

Komuna e Drenasit i ka 22 shkolla fillore dhe 8 paralele të ndara, si dhe 25 paralele për fëmijë parashkollorë, 2 shkolla të mesme, 3 kopshte për fëmijë.

Tabela 2. Institucionet shkollore

Emri	Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
Parafillor	25 class rooms	658	25
Shkolla fillore	22	11,686	535
Shkolla të mesme	2	2,921	149

Ekziston një disproporcion i madh ndërmjet nivele të ndryshme të edukimit, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve. Posaçërisht ekziston numër i ulët i nxënësve të cilët vazhdojnë shkollën e mesme pasi ta mbarojnë atë fillore.

Ekonomia

Para luftës së vitit 1999, bartëse kryesore e zhvillimit të ekonomisë së komunës së Drenasit ishte industria, me një pjesëmarrje relativisht të lartë - 66.7 %. Aktivitetet tjera ekonomike siç janë: bujqësia, tregtia dhe hoteleria, komunikacioni, ndërtimtaria, zëjtaria etj. kanë pjesëmarrje të vogël.

Në sektorin e ndërmarrjeve me pronësi shoqërore dhe publike, vetëm gjysma e tyre, prej 12 sa janë gjithsej punojnë me gjysmën e kapaciteteve të tyre.



Foto 1: “Ferronikeli”

Privatizimi ende nuk ka filluar.

Pritet që Ferronikeli të privatizohet kah fundi i këtij viti. Gjithashtu, pritet që privatizimi i suksesshëm të ketë efekte pozitive në komunë.

Tabela 3. Subjektet ekonomike në komunën e Drenasit

Emri i subjektit afarist	Numri i punëtorëve		Vërejtje
	Para vitit 1999	Tani	
NUSH “Ferronikeli”	2200	130	Nuk punon
Separacioni i gurëve “Ramiz Sadiku”	120	80	Punon me kapacitet 35%
Separacioni i gurëve “PUT”		92	Punon me kapacitet 30%
OP “Drenica”	380	50	Punon
Fabrika e konfeksionit “Kluz”	318		Nuk punon
Ferma për majmërinë e viçave	61		Nuk punon
Ferma e brojlerëve	120		Nuk punon
OTHPB “Veterinari”	12	6	Punon
OTHPB “Kosovatrans”	96	35	Punon
OTHPB “19 Nëntori”	89		Nuk punon
Komunalia	30	50	Punon

Bujqësia

Komuna e Drenasit ka sipërfaqe prej 27.100 hektarë, prej tyre 16,205 hektarë janë tokë bujqësore (shiko tabelën 4). Nën sistemin e ujitjes janë 5600 ha, ndërsa në 4960 ha është aplikuar masa e komasacionit, si potencial i prodhimitarisë bujqësore. Bujqësia e kësaj komune ka qenë dhe është e organizuar në dy sektore:

- a) Sektori privat me 88.7% dhe
- b) Sektori shoqëror me 11.3%

Tabela. Veçoritë e tokës në Drenas

Lloji i tokës	Sipërfaqja	Sektori privat	Sektori publik/ shoqëror
Tokë bujqësore	16,205 ha	88.7 %	11.3%
Pyje	10,895 ha	66 %	34 %
Gjithsej	27,100 ha		

Burimi: Drejtorati për Bujqësi, 2004

Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Në këtë rajon ka një klimë të mesme kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të ngrohtë. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në periudhën e vegjetacionit (prill-shtator) afër 330mm. Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% të sipërfaqës gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimitarisë bujqësore.



Bizneset dhe struktura e tyre

Në komunën e Drenasit, pas luftës së vitit 1999, ka pasur një rritje të regjistrimit të bizneseve private. Deri në fund të vitit 2003 janë regjistruar 1494 biznese. Prej tyre, shumica e ndërmarrjeve të reja janë themeluar si ndërmarrje tregtare.

Table 5. Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve

Nr.	Aktivitetet	Bizneset e regjistruara	%
1	Bujqësia	22	1.4 %
2	Industria	71	4.7 %
3	Ndërtimtaria	243	16.2 %
4	Tregtia	708	47.3 %
5	Transporti	257	17.2 %
6	Hotelieria	60	4.0 %
7	Financat	3	0.2 %
8	Shërbimet	48	3.2 %
9	Të tjera	82	5.5 %
	Gjithsej	1,494	100 %

Burimi: Drejtorati për Ekonomi, Drenas, 2003

Struktura biznesore është e pavolitshme. Bizneset aktive në sektorin e bujqësisë dhe të industrisë kanë së bashku një pjesëmarrje më të vogël se 7%, paraqitur në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve (tabela 5). Ndërtimtaria dhe ndërmarrjet transportuese janë më mirë të zhvilluara. Drenasi nuk ka kurrfarë përjashtimi as të ndërmarrjet tregtare, përderisa numri i tyre në komunë i tejkalon të tjerat. Bizneset nuk janë të regjistruara ende në Shoqata të Biznesit. Gjatë procesit të ZHEL-it, kjo çështje është adresuar dhe besohet se do të zgjidhet.

Për ta hulumtuar shkakun e strukturës së pavolitshme të bizneseve janë bërë tri anketime: një anketim e ka organizuar pushteti lokal, ku janë anketuar 12 biznese, një Instituti “Riinvest”, ku janë anketuar 7 biznese, dhe një ekip i ZHEL-it, ku janë anketuar 19 biznese të ndryshme.

Në anketën që e ka organizuar pushteti janë identifikuar tri çështje kyçe:

- Nuk ka pasur ndihmë nga qeveria lokale
- Veprimtaria me perspektivë është veprimtaria prodhuese
- Formimi i shoqatës së biznesit do ta ndihmonte biznesin

Në anketën që e ka organizuar Instituti “Riinvest” janë identifikuar këto tri çështje kyçe:

- Taksat dhe ngarkesat janë të pavolitshme
- Rregulloret mbivendosen, ripërsëriten apo kanë kontradikta
- Furnizimi i dobët me energji elektrike

Anketa që e ka organizuar ekipi i ZHEL-it ka nxjerrë këto tri çështje kyçe:

- Organizimi dhe bashkëpunimi i ulët i bizneseve
- Kushtet e pavolitshme të kreditimit
- Mbështetja e qeverisë lokale

III. ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)

<i>Përparësitë</i>	<i>Dobësitë</i>
<ul style="list-style-type: none"> Ü Plani urbanistik me zona funksionale, Ü Pozita qendrore në Kosovë, Ü Resurset nëntokësore (feronikeli, uji mineral, guri gëlqeror), Ü Toka bujqësore (5,600 ha nën ujitje), Ü Raporte të mira të shoqërisë civile me qeverinë lokale, Ü Niveli i kënaqshëm i sigurisë. 	<ul style="list-style-type: none"> Ü Struktura jo e mirë e biznesit, Ü Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë lokale dhe komunitetit të biznesit në të mirë të ZHEL-it, Ü Komunikimi i dobët me Diasporën, Ü Shkalla e ulët e punësimit - varfëria e madhe
<i>Mundësitë</i>	<i>Rreziqet</i>
<ul style="list-style-type: none"> Ü Privatizimi i Feronikelit dhe NSH-ve të tjera, Ü Aktivizimi i zonës së biznesit (parku industrial), Ü Riaktivizimi i sistemit të ujitjes, Ü Ndërtimi i rrugëve rajonale, Ü Përmirësimi i kushteve të kreditimit. 	<ul style="list-style-type: none"> Ü Statusi i padefinuar politik i Kosovës, Ü Pengesat në zbatimin e privatizimit, Ü Lëvizja e kuadrove drejt qendrave të mëdha, Ü Furnizimi jo i mirë me energji elektrike.

IV. VIZIONI

Drenasi do të jetë komunë me qeveri lokale efikase, me ambient të qetë, bujqësi dhe industri të zhvilluar, me partneritet dhe kushte të përshtatshme për zhvillimin e biznesit privat. Do të jetë joshës për investime sipas trendeve të zhvillimit ekonomik në hapësirë të urbanizuar, duke ruajtur dhe ngritur vlerat e urbanistikës rurale.

V. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT

S.1. Funkcionimi i një qeverie lokale të qëndrueshme, e cila siguron kushte për zhvillim ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut, e cila bashkëpunon ngusht me komunitetin e biznesit dhe nxit investitorët, duke respektuar barazinë gjinore.

S1:O1: Ngritja e profesionalizimit të qeverisë lokale, duke përfshirë në forma të ndryshme të aftësimit 50% të administratës komunale.

S1:O2: Inkuadrimi i gruas në shoqëri.

S1:O3: Deri në vitin 2007 të arrihet mesatarja e investimeve brenda komunës me nivelin mesatar të vendit.

S.2. Sigurimi i infrastrukturës fizike racionale, e cila ndikon në grupimin e bizneseve.

S2:O1: Rritja e investimeve në infrastrukturë të jetë për çdo vit në shkallë 10%, duke mundësuar shtrirjen e infrastrukturës nëpër lokalitetet ku zhvillohen bizneset, njëkohësisht duke ulur koston e shpenzimeve për infrastrukturë 30% deri në vitin 2007.

S2:O2: Deri në vitin 2007, 40% e bizneseve të reja të vendosen në lokacionin me infrastrukturë të rregulluar brenda zonave funksionale të biznesit.

S.3. Kalimi nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive.

- S3:O1:** Kultivimi i kulturave intensive perimore, pemëtare dhe industriale, duke rritur rendimentet deri në vitin 2007 për 100%, sipërfaqja të dyfishohet.
- S3:O2:** Përmirësimi i fondit blegtoral me raca fisnike, të cilat deri në vitin 2007 do ta mbulojnë territorin tonë mbi 80%.

S.4. Përmirësimi i standardit arsimor, jetësor në një ambient të shëndoshë dhe human.

- S4:O1:** Përmirësimi i standardit jetësor në shkallë 20% për çdo vit në vëndbanimet rurale, duke siguruar rrugë të asfaltuara për të gjithë banorët e komunës dhe që 60% e banorëve të kenë qasje në ujësjellësin publik, kanalizimin dhe telefoninë fikse deri në vitin 2007.
- S4:O2:** Përmirësimi i standardit jetësor për 10% për çdo vit për sigurimin e një ambienti human-ekologjik.
- S4:O3:** Ngritja e efikasitetit në menaxhimin e ambientit
- S4:O4:** Ngritja e objekteve publike administrative në bashkësi për nevojat e komunitetit në shkallë 60%.

VI. AMZA: NGA VIZIONI DREJT PROJEKTET

<i>Vizioni</i>	<i>Synimet</i>	<i>Objektivat</i>	<i>Programet</i>	<i>Projektet</i>
Drenasi do të ketë qeveri lokale efikase, do të sigurojë ambient të qetë, bujqësi dhe industri të zhvilluar. Partneritet dhe kushte të përshtatshme për zhvillimin e biznesit privat. Do të ketë ambient për investime, duke siguruar masa nxitëse, infrastrukturë, hapësirë të urbanizuar për zhvillimin e biznesit, duke ruajtur dhe ngritur vlerat e urbanistikës rurale.	S1: Funksioni i një qeverie lokale të qëndrueshme, e cila siguron kushte për zhvillim ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut, e cila bashkëpunon ngusht me komunitetin e biznesit dhe nxit investitorët, duke respektuar barazinë gjinore.	S1: O1: Ngritja e profesionalizimit të qeverisë lokale, duke përfshirë në forma të ndryshme të aftësimin 50% të administratës komunale.	S1: O1: PG1: Programi i përmirësimit të shërbimeve dhe krijimi i partneritetit ndërmjet qeverisë lokale dhe biznesit.	S1: O1: PG1: p1: Trajnimi i stafit të administratës, që është i lidhur drejtpërdrejt me biznesin.
				S1: O1: PG1: p2: Trajnimi i komunitetit të biznesit lidhur me procedurat administrative për fillimin e bizneseve të reja.
				S1: O1: PG1: p3: Trajnimi i përbashkët i stafit të administratës dhe komunitetit të biznesit.
				S1:O1:PG1:p4: Formimi i asociacionit të biznesit.
				S1: O1: PG1: p5: Organizimi i një zyre komunale për shërbim të shpejtë të komunitetit të biznesit.
			SI: O1:PG2: Programi për përmirësimin e shkallës së zgjidhjes së ankesave të qytetarëve për realizimin e vendimit për komasacion.	SI: O1:PG2: p1: Komisioni për komasacion.
		S1:O2: Inkuadrimi i gruas në shoqëri.	S1:O2:PG1: Programi për nxitjen e gruas për përfshirjen në biznes dhe ngritja e shkallës së planifikimit të familjes.	S1:O2:PG2:p1: Trajnimi në rrobaqepësi i grave kryefamiljare. S1:O2:PG2:p1: Fushata për shëndetin e gruas dhe familjes.
		S1: O3: Deri në vitin 2007 të arrihet mesatarja e investimeve brenda komunës me nivelin mesatar të vendit.	S1: O3: PG1: Programi për shpërndarjen e informatave për mundësitë e investimeve.	S1: O3: PG1: p1: Krijimi i uebsajtit (web-site). S1:O3:PG1:p2: Projekti për lehtësira - nxitje të investimeve.

	<p>S2: Sigurimi i infrastrukturës fizike racionale, e cila ndikon në grupimin e bizneseve.</p>	<p>S2: O1: Rritja e investimeve në infrastrukturë të jetë për çdo vit në shkallë 10%, duke mundësuar shtrirjen e infrastrukturës nëpër lokalitetet ku zhvillohen bizneset, njëkohësisht duke ulur koston e shpenzimeve për infrastrukturë 30% deri në vitin 2007.</p>	<p>S2: O1: PG1: Programi për përmirësimin e fondit të infrastrukturës.</p>	<p>S2: O1: PG1:p1: Infrastruktura në zonat rurale.</p>
				<p>S2:O1:PG1:p2: Infrastruktura në zonat e biznesit</p>
				<p>S2: O2: PG1:p3: Kadastrri nëntokësor</p>
				<p>S2: O2: PG1:p4: Projekti për parkun industrial.</p>
	<p>S2: O2: Deri në vitin 2007, 40% e bizneseve të reja të vendosen në lokacionin me infrastrukturë të rregulluar brenda zonave funksionale të biznesit.</p>	<p>S2: O2: PG1: Programi për organizimin e bizneseve dhe ndërmarrësit e rinj.</p>	<p>S2: O2: PG1:p1: Projekti për inkubatorin e biznesit.</p>	
			<p>S2: O2: PG1:p2: Qendra për këshilla të biznesit</p>	
			<p>S2:O2:PG1: p3: Projekti përndërmarrësit e rinj</p>	
	<p>S2:O2:PG2: Programi për zhvillimin e veprimtarive prodhuese.</p>	<p>S2:O2:PG2:p1: Projekti për prodhimin e ujit mineral</p>		
<p>S3: Kalimi nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive.</p>	<p>S3: O1: Kultivimi i kulturave intensive perimore, pemëtare dhe industriale, duke rritur rendimentet deri në vitin 2007 për 100%, sipërfaqja të dyfishohet.</p>	<p>S3: O1: PG1: Programi për kultivimin e kulturave pemëtare, perimore dhe industriale.</p>	<p>S3: O1: PG1: p1: Projekti për ndërrimin e kulturave rreth lumit Drenica.</p>	
			<p>S3: O1: PG1: p2: Projekti për rritjen e fondit të pemëve në zonat rurale.</p>	
	<p>S3: O2: Përmirësimi i fondit blegtoral me raca fisnike, të cilat deri në vitin 2007 do ta mbulojnë territorin tonë mbi 80%.</p>	<p>S3: O2: PG1: Programi për prodhimtarinë blegtorale.</p>	<p>S3: O2: PG1: p1: Projekti për ngritjen e stallave.</p>	
			<p>S3: O2: PG1: p2: Projekti për fondin blegtoral.</p>	
			<p>S3: O2: PG1: p3: Projekti për qendrën grumbulluese të qumështit.</p>	

	<p>S4: Përmirësimi i standardit arsimor dhe jetësor në ambient të shëndoshë dhe human.</p>	<p>S4: O1: Përmirësimi i standardit jetësor në shkallë 20% për çdo vit në vëndbanimet rurale, duke siguruar rrugë të asfaltuara për të gjithë banorët e komunës dhe që 60% e banorëve të kenë qasje në ujësjellësin publik, kanalizimin dhe telefoninë fikse deri në vitin 2007.</p>	<p>S4: O1: PG1: Programi për përmirësimin e infrastrukturës dhe standardit jetësor.</p>	<p>S4: O1: PG1: p1: Projekti për telefoninë fikse.</p> <p>S4: O1: PG1: p2: Infrastruktura në zonat urbane.</p> <p>S4: O1: PG1: p3: Projekti për rrugën rajonale Drenas-Guri i Plakës-Fushë Kosovë.</p> <p>S4: O1: PG1:p4: Infrastruktura në lagjen e dëshmorëve „Drenasi i Ri“.</p> <p>S4: O1: PG1:p5: Gjysmëunaza (Ruga e UÇK-së).</p> <p>S4: O1: PG1: p6: Nyjelloret (rrethi).</p> <p>S4: O1: PG1:p7: Nënkalimi në udhëkryqin e hekurudhës.</p> <p>S4: O1: PG1: p8: Projekti i rrugës së rendit të katërt Drenas-Abri, Sankovc-Vasilevë, Vuqak, Dodonë, Qendra e qytetit.</p> <p>S4: O1: PG1: p9: Projekti për ujësjellës, Bushat, Verbovc, Terstenik II, Drenas III.</p>
			<p>S4: O1: PG2: Programi për përmirësimin e standardit shkollor.</p>	<p>S4: O1: PG2:p1: Projekti për infrastrukturën shkollore, Drenasi II, Drenasi i Ri, Negrovç, Polluzhë.</p> <p>S4: O1: PG2: p2: Organizimi i qendrës për aftësim profesional.</p>

		<p>S4: O2: Përmirësimi i standardit jetësor për 10% për çdo vit për sigurimin e një ambienti human-ekologjik.</p>	<p>S4: O2: PG1: Programi për përmirësimin e ambientit.</p>	<p>S4: O2: PG1: p1: Projekti i shtratit të lumit Drenica.</p> <p>S4: O2: PG1: p2: Projekti për pjerrina (për persona me aftësi të kufizuara)</p> <p>S4: O2: PG1: p3: Projekti për gjelbërimin e qytetit.</p> <p>S4: O2: PG1: p4: Projekti për rregullimin e mjedisit shkollor.</p> <p>S4: O2: PG1: p5: Projekti për rregullimin e liqejve në Vasilevë.</p> <p>S4: O2: PG1: p6: Ofiçinat për vënien e katalizatorëve dhe mirëmbajtje teknike.</p> <p>S4: O2: PG1: p7: Projekti për rregullimin e sheshit "Skënderbeu"</p> <p>S4: O2: PG1: p8: Projekti për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara nga lufta dhe atyre për banim social.</p> <p>S4: O2: PG1: p9: Projekti për qendrën sportive-rekreative në qytet.</p>
		<p>S4: O3: Ngritja e efikasitetit në menaxhimin e ambientit</p>	<p>S4: O3: PG1: Marrja e përgjegjësisë në menaxhimin e ambientit.</p>	<p>S4: O3: PG1: p1: Projekti për pastrimin e lumit Drenica.</p> <p>S4: O3: PG1: p2: Projekti për pastrimin e sipërfaqeve publike.</p>
		<p>S4: O4: Ngritja e objekteve publike administrative në bashkësi për nevojat e komunitetit në shkallë 60%.</p>	<p>S4: O4: PG1: Programi për shërbime administrative</p>	<p>S4: O4: PG1: p1: Ndërtimi i qendrave të komunitetit.</p>

VII. AMZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNNIMET

Synnimet		Funksionimi i një qeverie lokale të qëndrueshme, e cila siguron kushte për zhvillimin ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut, e cila bashkëpunon ngusht me komunitetin e biznesit dhe nxit investitorët, duke respektuar barazinë gjinore.	Sigurimi i infrastrukturës fizike racionale, e cila ndikon në grupimin e bizneseve.	Kalimi nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive.	Përmirësimi i standardit arsimor, jetësor, në ambient të shëndoshë dhe human.
PROJEKTET		S1	S2	S3	S4
1	Trajnimi i stafit të administratës, të cilët janë drejtpërdrejt të lidhur me biznes	X			
2	Trajnimi i komunitetit të biznesit lidhur me procedurat administrative për fillimin e bizneseve të reja.	X	X		
3	Trajnimi i përbashkët i stafit të administratës dhe komunitetit të biznesit	X			
4	Formimi i asociacionit të biznesit	X	X		
5	Organizimi i një zyre komunale për shërbim të shpejtë të komunitetit të biznesit	X	X		
6	Komisioni për komasacion			X	
7	Trajnimi në rrobaqepësi i grave kryefamiljare	X			X
8	Fushatë për shëndetin e gruas dhe familjes				X
9	Krijimi i uebsajtit (faqes në internet)	X	X		
10	Projekti për lehtësira për investime	X	X		
11	Infrastruktura në zonat rurale		X		
12	Infrastruktura në zonat e biznesit		X		
13	Kadastrri nëntokësor	X			
14	Parku industrial		X		
15	Inkubatori i biznesit		X		
16	Qendra për këshilla të biznesit	X	X		
17	Ndërmarrësit e rinj	X	X		
18	Prodhimi i ujit mineral		X		
19	Ndërrimi i kulturave bujqësore në të dy anët e lumit Drenica	X		X	
20	Rritja e fondit të pemëve në zonat rurale	X		X	
21	Ngritja e stallave			X	

Synimet		Funksionimi i një qeverie lokale të qëndrueshme, e cila siguron kushte për zhvillimin ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut, e cila bashkëpunon ngusht me komunitetin e biznesit dhe nxit investitorët, duke respektuar barazinë gjinore.	Sigurimi i infrastrukturës fizike racionale, e cila ndikon në grupimin e bizneseve.	Kalimi nga një bujqësi ekstensive në një bujqësi intensive.	Përmirësimi i standardit arsimor, jetësor, në ambient të shëndoshë dhe human.
PROJEKTET		S1	S2	S3	S4
22	Rritja e fondit blegtoral			X	
23	Qendra grumbulluese e qumështit			X	
24	Telefonia fikse		X		
25	Infrastruktura në zonat urbane		X		
26	Projekti për rrugën rajonale Drenas - Guri i Plakës - F. Kosovë		X		
27	Infrastruktura në lagjen e dëshmorëve „Drenasi i Ri“		X		
28	Gjysmëunaza (Rruga e UÇK-së)		X		
29	Nyjellore (Rrethi)		X		
30	Nënkalimi në udhëkryqin e hekurudhës		X		
31	Asfaltimi i rrugëve Drenas-Abri, Dodonë, Qendra e qytetit, Sankovc, Vasilevë, Vuçak		X		
32	Ujësjiellësi Bushat, Verbovc, Tersteniku II dhe Drenasi III		X		
33	Infrastruktura shkollore Drenasi II, Drenasi i Ri, Negrovç, Polluzhë		X		X
34	Qendra për aftësim profesional	X			X
35	Rregullimi i shtratit të lumit Drenica		X	X	X
36	Pjerrinat për persona me aftësi të kufizuara	X	X		X
37	Gjelbërimi i qytetit	X			X
38	Rregullimi i mjedisit shkollor				X
39	Rregullimi i liqejve në Vasilevë		X		X
40	Ofiçina për vënien e katalizatorëve dhe mirëmbajtje teknike	X			X
41	Rregullimi i sheshit „Skënderbeu“		X		X
42	Rindërtimi i shtëpive të shkatërruara nga lufta dhe banimi social		X		X
43	Qendra sportive-rekreative në qytet	X	X		X
44	Pastrimi i lumit Drenica	X	X		X
45	Pastrimi i sipërfaqeve publike	X			X
46	Qendra e komunitetit	X			X

Struktura e projekteve është si vijon:

- a) Infrastrukturë institucionale dhe ngritje e kapaciteteve, 17 projekte
- b) Infrastrukturë fizike, 29 projekte

Vlera e përgjithshme e investimeve në projektet e identifikuara është 41,598,323 Euro.

Burimet e financimit planifikohen nga:

- 1) Burimet komunale 17.5%
- 2) Komuniteti 5.1%
- 3) Donatorët 77.4%

Pasqyra detale e projekteve është si në tabelën 8.

VIII. PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKETEVE TE ZHELIT

Nr	Titulli i projektit	Vlera totale	Burimet e fondeve(%)			Partnerët implementues	Kohëzgjatja	Data e fillimit	Grupi cak/përfutuesit
			Komuna	Komuniteti	Donatorët				
1	Trajnimi i stafit të administratës, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me biznes	825	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	1 muaj	15.01.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
2	Trajnimi i komunitetit të biznesit lidhur me procedurat administrative për fillimin e bizneseve të reja.	6,625	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	2 muaj	15.02.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
3	Trajnimi përbashkët i stafit të administratës dhe komunitetit të biznesit	1,150	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	1 muaj	15.04.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
4	Formimi i asociacionit të biznesit	700	100	-	-	Qeveria lokale	1 muaj	02.05.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
5	Organizimi i një zyre komunale për shërbim të shpejtë të komunitetit të biznesit	3,500	60	-	40	Qeveria lokale, Donatorët	1 muaj	01.06.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
6	Komisioni për komasacion	72,000	10	-	90	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.07.2005	Qeveria lokale Komuniteti
7	Trajnimi në rrobaqepësi i grave kryefamiljare	23,650	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.05.2005	Qeveria lokale Gratë kryefamiljare
8	Fushatë për shëndetin e gruas dhe familjes	4,200	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	1 vit	01.05.2005	Qeveria lokale Komuniteti
9	Krijimi i uebsajtit (faqes në internet)	5,250	100	-	-	Qeveria lokale	3 muaj	01.03.2005	Qeveria lokale Komuniteti i biznesit
10	Projekti për lehtësira për investime	104,925	100	-	-	Qeveria lokale	3 vite	03.01.2005	Komuniteti, Qeveria lokale
11	Infrastruktura në zonat rurale	1,440,230	40	30	30	Qeveria lokale, Donatorët, Komuniteti	3 vite	01.03.2005	Komuniteti, Qeveria lokale
12	Infrastruktura në zonat e biznesit	1,328,400	10	-	90	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.04.2005	Biznesi, Qeveria lokale
13	Kadastrri nëntokësor	7,500	100	-	-	Qeveria lokale,	2 vite	01.04.2005	Qeveria lokale Komuniteti

14	Parku industrial	27,100,000	10	-	90	Qeveria lokale, Donatorët, Komuniteti	2 vite	01.06.2006	Qeveria lokale Biznesi
15	Inkubatori i biznesit	27,000	50	10	40	Qeveria lokale, Donatorët, Komuniteti	3 muaj	02.05.2005	Qeveria lokale Biznesit
16	Qendra për këshilla të biznesit	23,000	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.09.2005	Qeveria lokale, Komuniteti i biznesit
17	Projekti për ndërmarrësit e rinj	2,000	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	1 muaj	01.09.2005	Komuniteti, Qeveria lokale
18	Projekti për prodhimin e ujit mineral	295,000	30	-	70	Qeveria lokale, Investitorët	1 vit	01.03.2006	Qeveria lokale, Komuniteti i biznesit
19	Ndërrimi i kulturave bujqësore në të dy anët e lumit Drenica	18,000	100	-	-	Qeveria lokale, Fermerët	1 vit	01.02.2005	Qeveria lokale, Fermerët
20	Rritja e fondit të pemëve në zonat rurale	90,000	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.07.2005	Qeveria lokale, Fermerët
21	Ngritja e stallave	165,000	40	10	50	Qeveria lokale, Komuniteti, Donatorët	2 vite	02.05.2005	Donatorët, Komuniteti
22	Rritja e fondit blegtoral	148,700	40	10	50	Donatorët, Komuniteti, Qeveria lokale,	3 vite	01.09.2005	Qeveria lokale, Fermerët,
23	Qendra grumbulluese e qumështit	63,280	20	10	70	Qeveria lokale Komuniteti, Donatorët	1 vit	01.03.2005	Qeveria lokale, Fermerët
24	Telefonia fikse	550	80	20	-	Qeveria lokale, Komuniteti	3 vite	02.01.2005	Qeveria lokale, Komuniteti
25	Infrastruktura në zonat urbane	1,099,865	25	25	50	Qeveria lokale, Donatorët, Komuniteti	3 vite	01.03.2005	Qeveria lokale Komuniteti
26	Projekti për rrugën rajonale Drenas - Guri i Plakës -Fushë Kosovë	910,000	30	20	50	Qeveria lokale Komuniteti, Qeveria qendrore	1 vite	02.05.2005	Qeveria lokale, Komuniteti, Qeveria Qendrore
27	Infrastruktura në lagjen e dëshmorëve „Drenasi i ri“	1,946,718	25	50	25	Qeveria lokale, Donatorët, Qeveria qendrore	3 vite	01.06.2005	Familjet e dëshmorëve, Qeveria lokale

28	Gjysmëunaza (Rruga e UÇK-së)	120,000	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	3 muaj	01.07.2005	Komuniteti, Qeveria lokale
29	Nyjellore (Rrethi)	30,000	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	2 muaj	01.06.2005	Komuniteti, Qeveria lokale,
30	Nënkalimi në udhëkryqin e hekurudhës	650,000	5	-	95	Qeveria lokale, Komuniteti, Qeveria qendrore	1 vit	01.06.2006	Komuniteti, Qeveria lokale, Qeveria qendrore
31	Asfaltimi i rrugëve Drenas-Abri, Dodonë, Qendra e qytetit, Sankovc, Vasilevë, Vuqak	1,277,145	60	10	30	Qeveria lokale, Komuniteti, Qeveria qendrore	3 vite	01.03.2005	Komuniteti, Qeveria lokale,
32	Ujësjellësi Bushat, Vërbovc, Tërsteniku II dhe Drenasi III	310,230	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	02.05.2005	Komuniteti, Qeveria lokale
33	Infrastruktura shkollore Drenasi II, Drenasi i Ri, Negrovç, Polluzhë	714,000	25	10	65	Qeveria lokale, Q. qendrore, Donatorët	3 vite	01.03.2005	Komuniteti, Qeveria lokale,
34	Qendra për aftësim profesional	262,500	25	-	75	Qeveria lokale, Shkollat, Donatorët	1 vit	02.05.2005	Qeveria lokale, Nxënësit, Bizneset
35	Rregullimi i shtratit të lumit Drenica	359,980	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	01.07.2005	Komuniteti, Qeveria lokale,
36	Pjerrinat për persona me aftësi të kufizuara	22,250	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	2 muaj	01.03.2005	Qeveria lokale, Të hendikeparit
37	Gjelbërimi i qytetit	115,800	60	10	30	Qeveria lokale, Komuniteti, Donatorët	3 vite	01.03.2005	Qeveria lokale, Komuniteti
38	Rregullimi i mjedisit shkollor	30,000	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	3 vite	02.05.2005	Nxënësit, Arsimtarët
39	Rregullimi i liqejeve në Vasilevë	775,000	5	-	95	Qeveria lokale, Donatorët	2 vite	01.06.2006	Qeveria lokale, Komuniteti,
40	Ofiçina për vënien e katalizatorëve dhe mirëmbajtje teknike	40,000	30	-	70	Qeveria lokale, Donatorët	6 muaj	01.06.2005	Qeveria lokale, Shoqata e Invalidëve
41	Rregullimi i sheshit „Skënderbeu“	820,000	40	-	60	Qeveria lokale, Donatorët	1 vit	01.03.2006	Komuniteti, Qeveria lokale,
42	Rindërtimi i shtëpive të shkatërruara nga lufta dhe banimi social	800,000	20	-	80	Qeveria lokale, Diaspora, Donatorët, Qeveria qendrore	3 vite	01.04.2005	Qeveria lokale, Rastet sociale, Komuniteti

43	Qendra sportive-rekreative në qytet	16,100	50	-	50	Qeveria lokale, Donatorët	6 muaj	01.03.2005	Rinia, Sportistët
44	Pastrimi i lumit Drenica	1,250	90	-	10	Qeveria lokale, Donatorët	1 vit	01.03.2005	Komuniteti, Qeveria lokale,
45	Pastrimi i sipërfaqeve publike	36,000	100	-	-	Qeveria lokale	1 vit	01.03.2005	Qeveria lokale, Komuniteti
46	Ndërtimi i qendrës për komunitete	330,000	100	-	-	Qeveria lokale	3 vite	01.03.2005	Qeveria lokale, Komuniteti
	Gjithsej	41,598,323	17.5%	5.1%	77.4%				

PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE

<p align="center"><u>Projekti 1:</u> <u>Trajnimi i stafit të administratës, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me biznesin</u></p>	<p align="center"><u>Lloji i programit:</u> <u>Përmirësimi i shërbimeve</u></p>
<p><u>Përshkrimi i projektit</u></p> <p>Qeveria lokale do ta bëjë trajnimin e stafit të administratës, me qëllim që shërbimet e nevojshme për biznesin të jenë sa më korrekte, profesionale dhe të shpejta. Trajnimet e tilla do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e besimit më të madh ndërmjet administratës lokale dhe komunitetit të biznesit.</p>	
<p><u>Rezultatet e pritura</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrata lokale do të jetë më efikase - Njohja dhe eliminimi i pengesave të komunitetit të biznesit 	<p><u>Grupet e targetuara</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Komuniteti i biznesit
<p><u>Aketerët e mundshëm</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria lokale - Donatorët - Institutet 	<p><u>Kontributet në projekt</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqës i projektit - Financues i mundshëm - Asistencë teknike (këshilla)
